



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 95 Datë 25-09-2025

Për miratimin e Pjesëmarrjes së Bashkisë Korçë në zbatimin e Projektit “RISTOR- Rural Innovation centers for Sustainable and inclusive TOuRism -RISTOR” në kuadër të programit Interreg VI-A IPA Greqi- Shqipëri 2021-2027 si dhe miratimin e fondeve si pjesë e buxhetit të Bashkisë

Duke u bazuar në Nenin 25 pika 2 dhe neni 54 germa dh) i ligjit 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; në ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 24.9.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”; në VKB nr. 176 datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë”, si dhe në pikën 3.3 të Udhëzimit nr.10 datë 12.7.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”:

VENDOSI

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Bashkisë Korçë në zbatimin e projektit “RISTOR- Rural Innovation centers for Sustainable and inclusive TOuRism -RISTOR” në kuadër të programit Interreg VI-A IPA Greqi- Shqipëri 2021-2027
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë si përfaqësuesin e vetëm ligjor për firmosjen e çdo lloj dokumenti lidhur me këtë projekt.
3. Të miratojë financimin e huaj të projektit RISTOR në vlerën 16,993,362 lekë si pjesë të buxhetit të bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET AC122 00 Art. 6020000 02 +7,874,907 lekë (Prog. Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik, Bashkia)

SHTOHET AC122 00 Art. 2310000 02 +9,118,455 lekë (Prog Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik, Bashkia)

Buxheti i projektit në total është i ndarë sipas zërave më poshtë:

PB2 Bashkia Korce							
Njesia	Kosto stafi	Zyrë & administrim	Udhëtim & dieta	Ekspertizë e jashtme & shërbime	Pajisje	Infrastruktura & punime	Totali
Euro	22,000	3,300	3,300	77,960	16,500	96,130	219,190
Lek	2,132,020	319,803	319,803	7,555,104	1,599,015	9,315,958	21,241,703

Burimet e financimit të totalit të projektit janë në raportet 80% - kontribut nga Bashkimi European dhe 20% kontribut nga fondet e bashkisë. Tabela më poshtë reflekton burimet e financimit:

PB2 Bashkia Korce								
	Kosto stafi	Zyrë & administrim	Udhëtim & dieta	Ekspertizë e jashtme & shërbime	Pajisje	Infrastruktura & punime	Totali euro	Totali Lek
Kontribut i financimit të huaj 80%	0	0	3,300	77,960	16,500	77,592	175,352	16,993,362
Kontribut i Bashkisë 20%	22,000	3,300	0	0	0	18,538	43,838	4,248,341
Totali euro	22,000	3,300	3,300	77,960	16,500	96,130	219,190	21,241,703

- Vlera e kontributit të bashkisë prej **4,248,341** lek, përfshin tre zërat e mëposhtëm:
 - Kosto stafi për vlerën 2,132,020 ALL, është kontribut në natyrë i bashkisë.
 - Zyrë dhe administrim për vlerën 319,803 ALL, është kontribut në natyrë i bashkisë
 - Infrastruktura dhe punime për vlerën 1,796,518 ALL është kontribut në vlerë i bashkisë për punimet në infrastrukturë. Ky fond do të parashikohet në buxhetin e Bashkisë për vitin 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK si dhe Sektori i Integritit European.
 5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore", i ndryshuar

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

Miratur me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 25-09-2025

